



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.152

18 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 10 335 datë 14.10.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian “Europa Juglindore dhe Mesdheu” të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkuftar për vitin 2009”” 8061
Vendim i KM nr.822, datë 6.10.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1290, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar..... 8075
Vendim i KM nr.824, datë 13.10.2010	Për pjesëmarrjen në stërvitje të dy kompanive të forcave tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC), në Hohenfels, Gjermani..... 8076
Vendim i KM nr.826, datë 13.10.2010	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010 – 2011..... 8076
Vendim i KM nr.827, datë 6.10.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.488, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pronës së paluajtshme nr.663, truell, ish-reparti ushtarak i artillerisë, nr.6650 në Parangua, Berat, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes”” 8082

Vendim i KM nr.828, datë 13.10.2010	Për disa shtesa në vendimin nr. 1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010”....	8083
Vendim i KM nr.829, datë 28.7.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të pronës “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në Elbasan, dhe kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, te Ministria e Mbrojtjes, të pronës “Laborator ushqimi”, në Elbasan, si dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	8084
Vendim i KM nr.830, datë 13.10.2010	Për një shtesë në vendimin nr.903, datë 26.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit”.....	8085
Vendim i KM nr.831, datë 20.10.2010	Për ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencës Civile, për përballimin e situatës së krijuar, si pasojë e kushteve atmosferike.....	8085
Vendim i KM nr.835, datë 21.10.2010	Për një shtesë dhe ndryshim fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	8086
Vendim i KM nr.837, datë 21.10.2010	Për shkarkimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut Vlorë.....	8086
Vendim i KM nr.864, datë 23.7.2010	Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë.....	8087
Udhëzim i MF nr.37, datë 5.11.2010	Për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit.....	8089

LIGJ
Nr. 10 335, datë 14.10.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE “PËR PROGRAMIN E FINANCIMIT TË
PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË
OBJEKTIVIT TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN “EUROPA
JUGLINDORE DHE MESDHEU” TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAADERIMIT
(IPA), KOMPONENTI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial evropian “Europa Juglindore dhe Mesdheu” të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar për vitin 2009””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6741, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN E FINANCIMIT TË
PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË
BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN “EUROPA JUGLINDORE” DHE
“MESDHEU” NËN INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA),
KOMPONENTI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR, PËR VITIN 2009**

(Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si “palët”, ose individualisht si “vendi përfitues”, në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të ndihmës së paraaderimit (këtej e tutje: “Rregullorja Kuadër IPA”). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (aktualisht Kroacia, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet candidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

8061

Bashkuara) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian;

b) Më 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: "Rregullorja e zbatimit IPA");

c) Asistenca komunitare, nën instrumentin e asistencës për paraaderim, duhet të vazhdojë t'i mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë;

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural;

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit;

e) Më datë 20 dhjetor 2007, Komisioni adoptoi programet operacionale ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu", me anë të vendimeve C (2007) 6590 dhe 6578 respektivisht;

f) Më datë 25 gusht 2009, Komisioni miratoi programin mbi financimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit, komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, për vitin 2009 (këtej e tutje: "programi"). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar;

g) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. PROGRAMI

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: CRIS 2009/021-162

Titulli: Programi i financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën komponentin IPA – Bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2009.

2. ZBATIMI I PROGRAMIT

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të Rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve, të ndryshuar sipas Rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje: "Rregullorja financiare").

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës, në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: "Marrëveshja kuadër"), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA, në përputhje me marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së së paraaderimit nën instrumentin IPA.

2. Koordinator kombëtar IPA do të jetë gjithashtu përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet

transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e këtij programi. Kjo strukturë operuese duhet të bashkëpunojë me autoritetin menaxhues të programeve transnacionale “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” dhe do të përfaqësohet në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të këtij programi si anëtare me të drejta të plota.

4. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës operuese përjashtojnë tenderimin, kontraktimin dhe pagesat, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. FINANCIMI

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2009 për pjesëmarrjen në programet transnacionale ERDF është përcaktuar në një maksimum prej 600 202 €, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Deri në 10% të këtij kontributi mund të përdoret për të bashkëfinancuar kostot operacionale dhe administrative të shpenzuara nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

5. AFATI PËRFUNDIMTAR PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale të cilat zbatohen këtë Marrëveshjeje, do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. AFATI PËR EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i ekzekutimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. AFATI I DISBURSIMIT

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data e fundit e zbatimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

8. TRAJTIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, në kuadër të IPA-s, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose fatura të tjera ekuivalente me përjashtim:

a) të të ardhurave të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimit në firma;

b) të të ardhurave të nxjerra brenda kuadrit të një mase inxhinierie financiare, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Të ardhurat siç përkufizohet në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit, këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionale, në varësi të asaj nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. SHPENZIMET E LEJUESHME

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

- a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar, TVSH-në;
- b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- c) blerje, dhënie me qira ose me kredi e truallit dhe godinave ekzistuese;
- d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- e) kostot operacionale;
- f) pajisje të dorës së dytë;
- g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;
- i) kontribute në natyrë;
- j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

- a) Taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,
 - ii) është përcaktuar që ato vijnë nga përfituesi i fundit, dhe
 - iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim.
- b) Detyrimet për transaksione financiare transnacionale.
- c) Në rast se zbatimi i një aktiviteti kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive.
- d) Kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij.
- e) Kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjetra financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit.
- f) Shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkt të një aktiviteti i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Përlllogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht.
- g) Blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të projektit në fjalë.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritetet publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

- a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi i fundit gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti;
- b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë, nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht, ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ua ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë projekt.

Kostot e referuara në pikën (b) të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuar me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aktivitet.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programet transnacionale ERDF.

10. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. HAPAT PËR DECENTRALIZIMIN PA KONTROLLE EX-ANTE

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. INTERPRETIMI

1. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të ruajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat duhet t'i bëhen marrëveshjes së ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohen modifikime të këtyre rregulloreve, duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshjeje me anë të ndryshimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshjeje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

13. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE BOSHLLËQET E PAQËLLIMSHME

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshjeje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm nëpërmjet një dispozite e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet palëve.

2. Çdo ndryshim, për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve, do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi, pasi vendosen ndërmjet palëve.

15. PËRFUNDIMI

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshjeje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshjeje mund të përfundojë nga secila palë duke informuar me shkrim palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet që dalin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit mes palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila nga palët mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me Rregullat Fakultative të Gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Arbitrazh, që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë gjuha angleze. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga palët. Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelles.

17. NJOFTIME

1. Çdo komunikim, në lidhje me këtë Marrëveshje, do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim, në lidhje me këtë Marrëveshje, duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:

z. Helmuth Lohan

Shef i Delegacionit

Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri

Qendra e Biznesit "ABA", kati i 17-të

Rr. "Papa Gjon Pali II"

Tiranë – Shqipëri

Fax: + 355 4230752

Për vendin përfitues

znj. Majlinda Bregu

Ministër i Integrimit European

Rr. "Papa Gjon Pali II", nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Fax +355 4256267

18. NUMRI I ORIGJINALEVE

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. SHTOJCAT

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. HYRJA në FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë në datë

nga

znj. Majlinda Bregu

Ministër i Integrimit European

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit, në Tiranë në datë

nga

z. Helmuth Lohan

Shef i Delegacionit të Komisionit European

ANEKSI A
PROGRAMI I FINANCIMIT PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMET
TRANSNACIONALE ERDF TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA
JUGLINDORE" DHE 'MESDHEU', NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR TË INSTRUMENTIT IPA PËR VITIN 2009

ANEKSI B
MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE
DHE KËSHILLIT TË MINISTARVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DATË 18 TETOR
2007

ANEKSI C
RAPORTIMI

1. Struktura operuese përgjegjëse për pjesëmarrjen e vendit përfitues në programet transnacionale, duhet t'i dërgojë Komisionit dhe koordinatorit kombëtar IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e këtij programi.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) Progresin e bërë gjatë pjesëmarrjes në programet transnacionale dhe prioritetet në raport me qëllimet e tyre specifike të verifikueshme, me një përcaktim sasior të tyre, kudo dhe kurdo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akteve prioritare.

b) Hapat e ndërmarra nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave,

- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;

- përdorimin e asistencës teknike.

c) Masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat (a) deri në (c) të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën (b) të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

ANEKS
PROGRAMI I FINANCIMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET
TRANSNACIONALE TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA
JUGLINDORE" DHE "MESDHEU" NËN KOMPONENTIN IPA, BASHKËPUNIMI
NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009

1. Identifikimi

Përfituesi	Shqipëria
Numri CRIS	2009/
Viti	2009
Kosto	€ 600 202
Struktura operuese	Ministria e Integritit European
Autoriteti zbatues	Komisioni European
Data përfundimtare për miratimin e marrëveshjes së financimit	Maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2010

Data përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit. Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimet që mbulohen nga kjo marrëveshje financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të rregullores financiare. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes	2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi i sektorit	41010, 21010, 43030, 99810,32182
Zëri buxhetor përkatës	22.02.04.01
Menaxheri përgjegjës i programimit	Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C4
Menaxheri përgjegjës i zbatimit	Delegacioni i KE-së në Shqipëri, seksioni operacional

2. Programi

2.1 Hyrje

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë financiarisht – nëpërmjet fondeve të vitit 2009 të komponentit IPA bashkëpunimi ndërkuftar – pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet transnacionale ERDF “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” nën objektivin e bashkëpunimit territorial europian të fondeve strukturore 2007–2013.

Vendosja dhe zhvillimi i bashkëpunimit transnacional është një nga prioritetet e objektivit të Bashkëpunimit Territorial Europian të Fondeve Strukturore 2007–2013. Për këtë qëllim, territori i BE-së është ndarë në disa hapësira homogjene dhe vendet anëtare, pjesë e këtyre territoreve, janë ftuar të paraqesin një program operacional të bashkëpunimit transnacional – financuar nga Fondi Europian për Zhvillimin Rajonal (ERDF) – për hapësirën e dhënë.

Duke marrë në konsideratë përfshirjen e tyre gjeografike në këto dy hapësira homogjene – hapësira e Europës Juglindore dhe hapësira mesdhetare – vendet kandidate/kandidate potenciale janë ftuar të marrin pjesë në programet operacionale përkatëse. Hungaria (Europa Juglindore) dhe Franca (Hapësira mesdhetare) janë vendet ku ndodhen autoritetet menaxhuese. Autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë kanë pranuar ftesën dhe kanë vendosur të marrin pjesë në programin “Europa Juglindore” (që nga viti 2007) dhe programin “Mesdheu” (që nga viti 2009) me mbështetjen financiare të komponentit IPA bashkëpunimi ndërkuftar për vitin 2009.

I gjithë territori i Shqipërisë përfiton nga këto programe.

2.2 Objektivi i programit

Objektivi i këtij programi është i dyfishtë:

- Të mbështesë pjesëmarrjen e partnerëve të vendeve kandidate/kandidate potenciale në aktivitetet e bashkëpunimit transnacional me partnerë nga vendet anëtare;
- Të familjarizojë vendet kandidate/kandidate potenciale me programet e bashkëpunimit territorial të fondeve strukturore të BE-së në funksion të implementimit të tyre pas aderimit të këtyre vendeve në BE.

2.3 Akset prioritare

Programet ERDF “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” kanë si qëllim vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit transnacional nëpërmjet financimit të rrjeteve dhe veprimeve që çojnë në një zhvillim të integruar territorial, duke u përqendruar fillimisht në fushat e mëposhtme:

a) Inovacioni: krijimi dhe zhvillimi i rrjeteve shkencore dhe teknologjike dhe rritja e kapaciteteve inovative rajonale në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik (R&TD), të cilat kontribuojnë në mënyrë direkt në zhvillimin e balancuar ekonomik të zonës transnacionale. Aktivitetet mund të përfshijnë: krijimin e rrjeteve ndërmjet institucioneve të përshtatshme të arsimit dhe kërkimit terciar dhe SME-ve; krijimin e lidhjeve për të përmirësuar aksesin në dijet shkencore dhe transferimin e teknologjisë midis faciliteteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik dhe qendrave ndërkombëtare të ekselencës në këto fusha; binjakëzimi i institucioneve të transferimit të teknologjisë; dhe zhvillimi i instrumenteve të përbashkëta të inxhinierisë financiare me fokus tek mbështetja në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të SME-ve.

b) Mjedisi: aktivitete për menaxhimin e ujërave, përdorimin efiçent të energjisë, parandalimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e mjedisit, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: mbrojtjen dhe menaxhimin e baseneve ujore, zonave bregdetare, burimeve

detare, shërbimeve ujore dhe tokave të lagura; parandalimi i zjarreve, thatësisë dhe përmbytjeve; promovimi i sigurisë detare dhe mbrojtja ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike; dhe mbrojtja dhe përmirësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik dhe turizmit të qëndrueshëm.

c) Aksesibiliteti: aktivitete për të përmirësuar aksesin në shërbime cilësore të transportit dhe telekomunikacionit, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: investime në segmentet ndërkufitare të rrjeteve transeuropiane; përmirësimin e aksesit lokal dhe rajonal në rrjetet kombëtare dhe transnacionale; përmirësimin e ndërveprueshmërisë së sistemeve kombëtare dhe rajonale; dhe promovimin e teknologjive të avancuara në fushën e informimit dhe komunikimit.

d) Zhvillimi i qëndrueshëm urban: aktivitete për forcimin e zhvillimit policentrik në nivel transnacional, kombëtar dhe rajonal, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: krijimin dhe përmirësimin e rrjeteve urbane dhe lidhjeve urbane-rurale; strategji për të trajtuar çështje të përbashkëta urbane-rurale; ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe integrimi strategjik i zonave të zhvillimit.

Prioritetet duhet të implementohen kryesisht nëpërmjet ftesave unike për propozime që mbulojnë të gjithë territorin përfitues, duke përfshirë atë të vendeve kandidatë/kandidate potenciale. Ftesa e parë për propozime pritet të publikohet në vitin 2008.

Kriteret thelbësore të përzgjedhjes së projekteve dhe dhënies së granteve janë parashtruar në programet transnacionale përkatëse ERDF. Kriteret e detajuara të përzgjedhjes së projekteve dhe dhënies së granteve do të përshkruhen në paketën e aplikimit të ftesës për propozime (Udhëzuesi për aplikuesit).

Deri në 10% të fondeve IPA të alokuara për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu”, mund të përdoren për të bashkëfinancuar (deri në 85% të shpenzimeve të lejuara) kostot operacionale dhe administrative të shpenzuara nga autoritetet kombëtare gjatë implementimit të programeve.

Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, kostot e mëposhtme:

- mbështetje për strukturën operuese;
- shpenzimet për pjesëmarrjen në takime të ndryshme mbi implementimin e programit;
- kostot për pjesëmarrjen e stafit kombëtar në Sekretariatit e Përbashkët Teknik, me përjashtim të rrogave të zyrtarëve publikë dhe krijimin, sipas rastit, të antenës kombëtare të SPT-së ose pikat e informacionit;

- kostot administrative dhe operacionale, duke përfshirë kostot e përgatitjes, monitorimit dhe vlerësimit të programit dhe kostot për mbështetje për përgatitjen e projekteve, vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve, organizimin e takimeve që lidhen me programin, përkthimin, informimin dhe publicitetin.

Qëllimi kryesor i kontributit IPA për këtë zë shpenzimesh është të lehtësojë administrimin dhe implementimin efektiv dhe efikas të këtyre programeve në Shqipëri.

Përfituesit kryesorë të fondeve të asistencës teknike do të jenë struktura operuese, Sekretariati i Përbashkët Teknik, (duke përfshirë edhe antenën apo pikën e informacionit), çdo strukturë/organ tjetër, të lidhura me zhvillimin dhe implementimin e këtij programi dhe përfituesit e programit.

Duke marrë në konsideratë faktin që autoritetet kombëtare përkatëse (Struktura operuese ose koordinatori CBC – sipas kuptimit të nenit 22(2)(b) të Rregullores së Implementimit IPA) gëzojnë një situatë monopoli *de facto* (sipas kuptimit të nenit 168, paragrafi 1, nënparagrafi c i rregullave të implementimit të rregullores financiare) për të menaxhuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu”, një marrëveshje granti e drejtpërdrejtë për shumën e asistencës teknike të specifikuar në tabelën financiare në seksionin 3.1 pa një ftesë për propozime, duhet të nënshkruhet midis Komisionit (delegacionit të KE-së) dhe autoriteteve kombëtare përkatëse. Kjo marrëveshje granti direkt mund të nënshkruhet menjëherë, pasi marrëveshja e financimit që ka të bëjë me këtë program, të jetë nënshkruar. Aktivitetet që mbulojnë nga marrëveshja e grantit të drejtpërdrejtë (p.sh. asistencë teknike, vlerësimi, publiciteti etj.) mund të prokurohen më tej nga ai

që përfiton nga granti, në përputhje me nenin 120 të rregullores financiare¹ dhe nenit 184 të rregullores së zbatimit² të rregullores financiare.

2.4. Vështrim i shkurtër mbi eksperiencën e kaluar dhe në vazhdim në fushën e bashkëpunimit transnacional, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Gjatë vitit 2004–2006, fondet CARDS u përdorën edhe për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në programin e fqinjësisë "Hapësira qendrore, adriatike, danubiane dhe juglindore" (CADSES), një nga zonat e bashkëpunimit evropian transnacional për vitet 2000–2006 e mbuluar nga iniciativa INTERREG IIIB. Pjesëmarrja në programin CADSES, pararendësja e programit Europa Juglindore 2007–13, iu dha mundësinë e parë vendeve të Ballkanit Perëndimor të përfshihen në bashkëpunimin transnacional me vendet anëtare të BE-së dhe, në të njëjtën kohë, të familjarizohen me procedurat e programeve INTERREG.

Ndërsa programi CADSES u implementua nëpërmjet ftesave unike të përbashkëta për propozime, mësimet e nxjerra për pjesëmarrjen e vendeve kandidat/ kandidatë potenciale janë si më poshtë:

- Autoritetet kombëtare duhet të alokojnë burimet njerëzore të mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive në strukturat e menaxhimit të programit (Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, Komitetin e Përbashkët Drejtues/Vlerësues, Sekretariati i Përbashkët Teknik) dhe të ndjekin implementimin e programit/projekteve të vendeve të tyre. Një pjesë e vogël e fondeve të Komunitetit të alokuara për çdo vend kandidat/kandidat potencial duhet të jetë në dispozicion për të mbuluar kostot operationale të lidhura me implementimin e programit.

- Koordinimi efektiv midis delegacionit të KE-së dhe vendit pjesëmarrës kandidat/ kandidat potencial (p.sh. në aprovimin *ex-ante* të ftesave unike për propozime përpara publikimit të tyre) dhe midis vendit pjesëmarrës dhe autoritetit menaxhues, është thelbësore për të siguruar një implementim sa më të lehtë dhe në kohë të programit.

2.5. Të dhëna

("N" është data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit)

	N* (2009)	N+1 (kumulative)	N+2 (kumulative)
Numri i ftesave për propozime të bëra	1		
Norma e kontraktimit (%)		100%	
Numri i marrëveshjeve të granteve të drejtpërdrejta (fondet AT)	1		

* N është data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

2.6. Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrollet *ex ante* nga Komisioni

Në përputhje me nenin 8(4)c) të rregullores së zbatimit IPA, vendet përfituese duhet të përcaktojnë hapat me të dhëna indikative dhe afatet kohore për arritjen e decentralizimit pa kontrollet *ex-ante* nga ana e Komisionit.

Në Shqipëri, Këshilli i Ministrave miratoi në shtator 2007 një vendim për ngritjen e strukturave, autoriteteve dhe përcaktimin e përgjegjësive për implementimin e IPA-s sipas Sistemit të Decentralizuar të Implementimit (DIS). Në nëntor 2007, Ministria e Financave i paraqiti

¹ Rregullorja (KE, Euroatom) nr. 1605/2002 (GZ L 248, 16/09/2002, faqe 1)

² Rregullorja (KE, Euroatom) nr. 2342/2002 (GZ L 357, 31/12/2002, faqe 1)

Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit një propozim për funksionimin e Njësisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU), e cila dha komentet dhe këshillat e saj në lidhje me këtë propozim. Një projekt asistence teknike nën IPA 2007 ka filluar. Kontrata e shërbimeve pritet të përfundojë brenda datës 19 dhjetor 2008 dhe aktivitetet të fillojnë në datë 15 janar 2009. Planifikimi i aktiviteteve të propozuara nga konsulenti i kontraktuar, mund të ndahen në 2 faza: në fazën e parë, me kohëzgjatje një vit, konsulenti do t'i mbështesë autoritetet shqiptare në rishikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve që kërkohen për të përfunduar me sukses fazat 1 dhe 2 më sipër; gjatë fazës së dytë, me kohëzgjatje 6 muaj, konsulenti do të testojë strukturat e zhvilluara dhe përputhjen e tyre me kërkesat IPA DIS, dhe do të zhvillojë trajnime.

3. Buxheti për vitin 2009

3.1. Tabela financiare indikative 2009

	Kontributi i Komunitetit - IPA		Kontributi kombëtar		Totali (IPA plus kontributin kombëtar)	
	EUR. (a)	% (1)	EUR. (b)	(%)(1)	EUR. (c)=(a)+(b)	(%)(2)
Pjesëmarrja në programin transnacional "Europa Juglindore"	360 182	85	63 562	15	423 744	60
Pjesëmarrja në programin transnacional "Mesdheu"	180 000	85	31 765	15	211 765	30
Fondet e AT	60 020	85	10 591	15	70 611	10
TOTAL	600 202	85	105 918	15	706 120	100

1. Shprehur në % të totalit (IPA plus kontributin kombëtar).

2. Shprehur në % të totalit të madh (c). Tregon peshën relative të çdo prioriteti duke iu referuar fondeve totale (IPA + kombëtare).

3.2. Parimi i bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, që në rastin e këtij programi, është bazuar në shpenzimet totale.

4. Plani i implementimit

4.1. Hyrje

Ky program i siguron Shqipërisë, nëpërmjet fondeve të komponentit II të IPA-s, financimin e pjesëmarrjes së partnerëve të saj kombëtarë në projekte të bashkëpunimit transnacional në kuadër të programeve transnacionale "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu".

Hapat kryesore të implementimit do të jenë si më poshtë:

a) Autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë do të përcaktojnë një strukturë operuese, e cila do të merret me menaxhimin dhe implementimin e këtij programi. Struktura operuese do të bashkëpunojë me autoritetin menaxhues të programeve "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" dhe do të përfaqësohet në komitetet e përbashkëta të monitorimit të këtyre programeve si anëtare me të drejta të plota.

b) Komitetet e përbashkëta të monitorimit të programeve të mësipërme transnacionale do të përgatisin ftesat për propozime- paketat e aplikuesit (udhëzuesi për aplikuesit) për implementimin e programeve.

c) Përpara se të publikohet, njoftimi i ftesave për propozime dhe paketat e aplikuesve do të dërgohen në delegacionet e KE-së të vendeve kandidate/kandidate potenciale pjesëmarrëse në programet transnacionale, për aprovim *ex-ante*.

d) Për të përfituar nga financimi IPA, aktivitetet e përbashkëta duhet të përfshijnë përfitues edhe nga vendet anëtare, edhe nga vendet IPA. Aplikimet për aktivitete të përbashkëta duhet të identifikojnë një partner udhëheqës financiar me vendndodhje në një nga vendet anëtare për pjesën e

aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në territorin e BE-së me fonde ERDF, dhe nga një partner udhëheqës financiar në secilin prej vendeve kandidatë/ kandidatë potenciale pjesëmarrëse, për pjesën e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në këto vende dhe që financohen nga fondet IPA. Aplikimet duhet të bëjnë një ndarje të qartë midis aktiviteteve – dhe kostove të tyre – që zhvillohen në territorin e BE-së me fonde ERDF dhe ato që zhvillohen në këto vende dhe që financohen nga fondet IPA.

e) Komitetet e përbashkëta të monitorimit të programeve të mësipërme transnacionale janë përgjegjëse për përzgjedhjen e aktiviteteve të përbashkëta, në përputhje me rregullat e fondeve strukturore.

f) Raporti i vlerësimit dhe lista e projekteve të përzgjedhura për financim do t'i dërgohet delegacionit të KE-së për aprovim. Ky aprovim do të lidhet vetëm me pjesëmarrjen e partnerëve shqiptarë në projektet e përbashkëta përkatëse.

g) Delegacioni i KE-së në Shqipëri do t'ua alokojë grantet IPA partnerëve udhëheqës kombëtarë të cilët marrin pjesë në projektet e përbashkëta të përzgjedhura (ndërsa autoritetet menaxhuese të programeve “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” do t'ua alokojnë grantet ERDF partnerëve udhëheqës për pjesën e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në territorin e BE-së).

4.2 .Metoda e implementimit

Ky program do të implementohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni Europian në përputhje me nenin 53a të rregullores financiare³ dhe dispozitave korresponduese të rregullave të implementimit⁴.

Në rastin e menaxhimit të centralizuar, Komisioni:

- do të aprovojë ftesat për propozime dhe paketat e aplikuesve (udhëzuesin e aplikuesit) të hartuar nga strukturat e përbashkëta të menaxhimit të programeve transnacionale “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” përpara publikimit të tyre;

- do të konfirmojë formalisht projektet e përzgjedhura nga strukturat e përbashkëta të menaxhimit të programeve transnacionale “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” në të cilat marrin pjesë përfitues nga Shqipëria;

- do të ruajë, në të gjitha rastet, të drejtën për t'i alokuar grantin përfituesit udhëheqës nga Shqipëria, pjesëmarrës në projektin e përbashkët.

4.3. Rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve

Prokurimi duhet të zbatohet sipas dispozitave të pjesës II, titulli IV të rregullores financiare dhe pjesës II, titulli III, kapitulli 3 i rregullave të implementimit⁵, si dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjet dhe punimet të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta, adoptuar nga Komisioni në datë 24 maj 2007 (C(2007)2034).

Procedurat e dhënies së grantit duhet të ndjekin dispozitave të pjesës I, titulli VI të rregullores financiare dhe pjesës I, titulli VI të rregullave të tij të implementimit.

Sipas rastit, autoriteti kontraktues do të përdorë gjithashtu formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme të cilat ndodhen në “Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së” (“Udhëzuesi praktik”) publikuar në faqen e internetit të EuropeAid⁶ në datën e fillimit të procedurave të prokurimit ose dhënies së granteve.

³ Shiko shënimin 1 më sipër

⁴ Shiko shënimin 2 më sipër

⁵ Shih shënimin 1 dhe 2 më sipër

⁶ Adresa: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm

4.4. Vlerësimi i ndikimit mjedisor (EIA) dhe ruajtja e natyrës

Të gjitha investimet duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin komunitar mjedisor.

Procedurat për vlerësimin e ndikimit mjedisor parashikuar në direktivën⁷ EIA aplikohen plotësisht në të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar plotësisht, procedurat duhet të jenë të ngjashme me ato të vendosura në këtë direktivë.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalente me atë të nenit 6 të Direktivës së Habitatit, dhe duhet të dokumentohet⁸.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1. Monitorimi

Në Shqipëri, Komisioni mund të ndër marrë çdo veprim që ai e konsideron si të nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2. Vlerësimi

Programet transnacionale ERDF janë subjekt i vlerësimit në përputhje me Rregulloren e Fondeve Strukturore (EC) nr.1083/2006, nën përgjegjësinë e autoritetit menaxhues të vendosur në një nga vendet anëtare pjesëmarrëse. Kur një vlerësim i tillë është bërë, çdo përpjekje duhet të bëhet për të vlerësuar gjithashtu elementet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e vendeve kandidate/kandidate potenciale në programet transnacionale.

Ky program do të jetë subjekt i vlerësimeve, në përputhje me nenin 57 dhe 82 të rregullores së implementimit IPA, me qëllim përmirësimin e cilësisë, efektivitetit dhe konsistencës së asistencës nga fondet e Komunitetit dhe strategjisë dhe implementimit të programit.

Komisioni mund të zhvillojë gjithashtu edhe vlerësime strategjike.

6. Auditimi, kontrolli financiar dhe masat antimashtrim

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, janë subjekt, nga njëra anë, i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashtrimit), i cili mund të zhvillojë kontrole, kur e gjykon të arsyeshme, ose vetë ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm, nga ana tjetër, audituesve të Gjykatës Europiane të Llogarive. Kjo përfshin masa të tilla si p.sh. verifikimin *ex-ante* të tenderimeve dhe kontraktimeve të zhvilluara nga delegacionet e vendeve përfituese.

Me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje efikase të interesave financiarë të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashtrimit) mund të zhvillojë kontrole në vend dhe inspektive, në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96⁹.

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart aplikohen për të gjithë kontraktuesit, nënkontraktuesit dhe përfituesit e grantit që kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7. Ndryshime të kufizuara

Ndryshime të kufizuara në implementimin e këtij programi që kanë ndikim mbi elementet thelbësore të listuara në nenin 90 të rregullave të implementimit të rregullores financiare, e cila është e një natyre indikative¹⁰, mund të ndërmerren nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të delegimit (AOD), ose nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të nëndelegimit (AOSD), në përputhje me pushtetin e deleguar nga ana e AOD, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar, pa qenë i nevojshëm një vendim ndryshimi financiar.

⁷ Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, fq. 40). Direktive e amenduar se fundmi nga Direktiva 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, fq. 17.

⁸ Direktiva e Këshillit 92/43/EEC të datës 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitatit natyror dhe florës dhe faunës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktive e amenduar se fundmi nga rregullorja (EC) nr. 1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, fq. 1)

⁹ Rregullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 e datës 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; fq. 2.

¹⁰ Këto elemente thelbësore të natyrës indikative janë shuma indikative e ftesës për propozime dhe, për prokurimet, numri indikativ, lloji i kontratave i parashikuar dhe itinerari indikativ për fillimin e procedurave të prokurimit.

VENDIM I KOMISIONIT

C(2009) 6503 i datës 25 gusht 2009

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN “EUROPA JUGLINDORE” DHE “MESDHEU” NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA, PËR VITIN 2009

Komisioni i Komuniteteve Europiane,
duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Europian,
duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 të datës 17 korrik 2006 që krijon Instrumentin e Ndhmës së Paraaderimit (IPA)¹¹ dhe veçanërisht nenin 14, pika 2, shkronja (a) të saj,
meqë:

1. Rregullorja (KE) nr. 1085/2006 përcakton objektivat dhe parimet kryesore për asistencën e paraaderimit për vendet candidate dhe candidate potenciale.

2. Në përputhje me nenin 7, pika 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1085/2006, asistenca duhet të jepet nëpërmjet programeve vjetore ose shumëvjeçare, për vend, grup vendesh ose komponentë. Këto programe duhet të hartohen në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikës, siç përcaktohet në nenin 4 të rregullores nr. 1085/2006 dhe dokumentet planifikuese indikative shumëvjeçare relevante të referuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli ka vendosur një partneritet europian për Shqipërinë¹². Në datë 29 shtator 2008, Komisioni miratoi Dokumentin Planifikues Indikativ Shumëvjeçare 2008-2010 për Shqipërinë, i cili përmbledh prioritetet kryesore për ndihmën e paraaderimit për këtë vend¹³.

4. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (KE) nr. 1085/2006 dhe siç parashikohet në nenin 86(4) të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 718/2007 të datës 12 qershor 2007 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006, e cila krijon Instrumentin e Ndhmës së Paraaderimit (IPA)¹⁴, (këtëj e tutje referuar “Rregullorja e zbatimit IPA”), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar IPA mund të mbështesë gjithashtu, sipas rastit, pjesëmarrjen e zonave përfituese të vendit përfitues në programe transnacionale nën objektivin bashkëpunimi territorial europian i fondeve strukturore.

5. Duke pasur parasysh interesin e shprehur nga autoritetet kombëtare përgjegjëse, për vitin 2009, komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar IPA do të financojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet transnacionale ERDF-bashkëpunimi territorial europian “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu”. Këto programe kanë si qëllim të mbështesin krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit transnacional nëpërmjet financimit të rrjeteve dhe aktiviteteve që çojnë në një zhvillim të integruar territorial, duke u përqendruar fillimisht në fushat e mëposhtme prioritare: inovacioni, mjedisi, aksesit, zhvillimi i qëndrueshëm urban.

6. Ky vendim plotëson kërkesat e nenit 90 të Rregullores së Komisionit (KE, Euroatom) nr. 2342/2002 të datës 23 dhjetor 2002, e cila përcakton rregullat e detajuara për implementimin e Rregullores së Këshillit nr.1605/2002¹⁵ duke qenë kështu një vendim financimi sipas kuptimit të nenit 75(2) të Rregullores së Këshillit nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 të rregullores financiare të aplikuar për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane¹⁶.

7. Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit IPA, vendosi si më poshtë:

¹¹ GZ L 210, 31.7.2006, faqe 82

¹² Vendim i Këshillit 2008/210/KE i datës 18 shkurt 2008, GZ L 80, 19.3.2006, faqe 1-17

¹³ C(2008)XXXX

¹⁴ GZ L 170, 29.6.2007, faqe 1

¹⁵ GZ L 357, 31.12.2002, faqe 1

¹⁶ GZ L 248, 16.9.2002, faqe 1

Neni 1

Miratohet programi për financimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të bashkëpunimit territorial evropian “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA, për vitin 2009, siç përcaktohet në aneks.

Ky program do të zbatohet në mënyrë të centralizuar.

Ai do të zbatohet nëpërmjet marrëveshjes së financimit që do të nënshkruhet midis Komisionit dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjen kuadër të nënshkruar midis të njëjta palëve më datë 18 tetor 2007.

Neni 2

Shuma maksimale e kontributit të Komunitetit do të jetë 600 202 euro, dhënë nga zëri 22.020401 i buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për vitin 2009.

Nënshkruar në Bruksel,

Për Komisionin
Anëtar i Komisionit

VENDIM

Nr.822, datë 6.10.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1290, DATË 23.12.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË
SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA
FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1290, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës “ë” të pikës 2, pas fjalës “... bujqësisë ...” shtohen “... peshkimit dhe përpunimit të produkteve ujore ...”.

2. Në fund të paragrafit të parë të pikës 5, pas fjalëve “... sektorin e bujqësisë ...” shtohen “... peshkimit dhe përpunimit të produkteve ujore ...”.

3. Fjalja e dytë e paragrafit të dytë të pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon: “Garancia bëhet për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.824, datë 13.10.2010

**PËR PJESËMARRJEN NË STËRVITJE TË DY KOMPANIVE TË FORCAVE TOKËSORE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË QENDRËN E
BASHKUAR NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË (JMRC), NË HOHENFELS,
GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e 2 (dy) kompanive të forcave tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me personel, të përbërë nga 200 (dyqind) ushtarakë, në stërvitjen e përbashkët në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC), në Hohenfels, Gjermani.

2. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi i trupave kundër mjeteve shpërthyes të improvizuara dhe operacionet kundër rebelimit.

3. Kohëzgjatja e stërvitjes është nga data 9 - 30 nëntor 2010.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.826, datë 13.10.2010

**PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË
PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2010 - 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2010 - 2011, të jenë 8610, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 8130; |
| b) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 200; |

- c) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj 100;
- d) Kuota për të verbrit 20;
- dh) Kuota për romët/ ballkano-egjiptianët 20;
- e) Kuota për të përndjekurit politikë 100.

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të shpërndahen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuota e çdo programi studimi ndahet në raportin 4:1, përkatësisht, 80 % e kuotës jepet për pranimet e reja për programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 20 % për pranimet e reja për programe të dyta studimi.

3. Kuota për transferim studimesh, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Kuota për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe shpërndahet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Kuota e pranimeve për të verbrit ndahet për aplikantët me statusin e të verbrit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

7. Kuota e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga shoqatat respektive, përkatësisht, Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.

8. Kuota e pranimeve për të përndjekurit politikë ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë. Pranimet do të bëhen vetëm në rast të plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

9. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie apo çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

10. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

11. Aplikantët që dëshirojnë të ndjekin studimet me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

12. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2010 - 2011, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2010 - 2011, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Përrjashtohen nga tarifa e shkollimit aplikantët që fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, si program i parë studimi, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010 - 2011, të cilët u përkasin këtyre kategorive sociale: të verbrit, të shurdhërit, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijë të familjeve të punonjëseve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, fëmijë të ish-të përndjekurve politikë, fëmijë romë dhe ballkano - egjiptianë.

15. Këtë të drejtë e kanë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

16. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit, të ndarë në këste vjetore, në përputhje me kreditet e lëndëve që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

17. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

18. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare, shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për tarifën.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

KUOTA E PRANIMEVE TË REJA NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIM NË DISTANCË NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UD	UST	Σ
Histori	250	0	0	0	0	100	0	0	350
Gjeografi	250					100			350
Histori-gjeografi			100	100					200
Gjuhë-letërsi	250		100	100	110	100			660
Edukatë qytetare			80						80
Cikli i ulët			50	50	50	50	50		250
Cikli i ulët (Filiali Peshkopi)							60		60
Cikli i ulët parashkollor			100	100	75	100			375
Edukim fizik dhe sporte								50	50
Matematikë						60			60
Fizikë						60			60
Matematikë- Fizikë			70	100					170
Biologji-kimi			70	100		60			230
Biologji	200								200
Punë Sociale	100		100						200
Filozofi-sociologji			80						80
Psikologji-sociologji							100		100
Psikologji	100								100
Drejtësi	300					100	100		500
Drejtësi (Filiali Peshkopi)							60		60
Infermieri e përgjithshme	230		150		120		100		600
Infermieri e përgjithshme (Filiali Peshkopi)							60		60
Mami	60								60

Teknik imazherie	60								60
Teknik laboratori	60								60
Fizioterapi	60								60
Administrim publik				100					100
Administrim-biznes	200		105			100	150		555
Financë-kontabilitet	200		105	100	100	100	150		755
Financë-kontabilitet (Filiali Peshkopi)							60		60
Menaxhim					90				90
Turizëm				100	75	100			275
Marketing					75				75
Turizëm (Pogradec)					60				60
Menaxhim agrobiznesi		100			75				175
Ekonomi dhe P. Agrare		100							100
Financë-kontabilitet		100							100
Mbrojtje bimësh		50							50
Hortikulturë		50			75				125
Prodhim bimor		50							50
Zootekni dhe biznes blegtoral		50							50
Akuakulturë dhe menaxh. peshkimi		50							50
Agromjedis dhe ekologji		80							80
Tek. agroushqimore		50			75				125
Vreshtari-enologji		50							50
Inxhinier pyjesh		60							60
Inxhinier përpunim druri		60							60
Agromekanizim		50							50
GJITHSEJ	2320	900	1110	850	980	1030	890	50	8130

PROGRAMI I STUDIMIT	UPT
Inxhinieri. mekanike/Inxh.logjistikë prodhimi	40

Tabela nr.2.

**TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË PARË STUDIMI ME KOHË TË PJESSHME
PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të parë	Tarifë totale për prog. të parë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	700	126,000
2	Mbrojtje bimësh	700	126,000
3	Prodhim bimor	700	126,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	700	126,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	700	126,000
6	Agromjedis dhe ekologji	700	126,000
7	Agromekanizëm	700	126,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	750	135,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	750	135,000
10	Financë-kontabilitet	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11	Mbarështim pyjesh	700	126,000
12	Përpunim druri	700	126,000
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	700	126,000
14	Vreshtari enologji	700	126,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	750	135,000
2	Administrim-biznes	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			

3	Biologji	1,600	288,000
Fakulteti Histori-Filologji			
4	Histori	850	153,000
5	Gjeografi	850	153,000
6	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8	Psikologji	850	153,000
9	Punë sociale	850	153,000
Universiteti Politeknik Inxh.Mek. (Eduk.distancë)			
		1,800	324,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	850	153,000
2	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
3	Kontabilitet-financë	750	135,000
4	Administrim publik	750	135,000
5	Turizëm	750	135,000
6	Histori-gjeografi	850	153,000
7	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8	Bio-kimi	1,700	288,000
9	Matematikë-fizikë	600	108,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
10	Financë	750	135,000
11	Menaxhim	750	135,000
12	Marketing	750	135,000
13	Turizëm	750	135,000
14	Turizëm/Pogradec	750	135,000
Fakulteti i Mësuesisë			
15	Cikli i ulët	850	153,000
16	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
17	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Bujqësisë			
18	Agrobiznes	1,100	198,000
19	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
1	Punonjës social	850	153,000
2	Filozofi-sociologji	850	153,000
3	Gjuhë-letërsi	850	153,000
4	Histori-gjeografi	850	153,000
5	Edukatë qytetare	850	153,000
6	Financë-kontabilitet	750	135,000
7	Administrim-biznes	750	135,000
8	Cikli i ulët	850	153,000
9	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
10	Matematikë-fizikë	600	108,000
11	Biologji-kimi	1,700	288,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	750	135,000
2	Financë-kontabilitet	750	135,000
3	Turizëm	750	135,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave të Edukimit			
5	Cikli i ulët	850	153,000
6	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
7	Matematikë	600	108,000
8	Fizikë	600	108,000

9	Biologji-kimi	1,700	288,000
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	850	153,000
11	Histori	850	153,000
12	Gjeografi	850	153,000

Tabela nr.3.

**TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI ME KOHË TË PJESSHME
PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të dytë	Tarifë totale për prog të dytë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	1,300	234,000
2	Mbrojtje bimësh	1,300	234,000
3	Prodhim bimor	1,300	234,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	1,300	234,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	1,300	234,000
6	Agromjedis dhe ekologji	1,300	234,000
7	Agromekanizëm	1,300	234,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	850	153,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	850	153,000
10	Financë-kontabilitet	850	153,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11	Mbarështim pyjesh	1,300	234,000
12	Përpunim druri	1,300	234,000
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	1,300	234,000
14	Vreshtari biologji	1,300	234,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	1,500	270,000
2	Administrim-biznes	1,500	270,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			
3	Biologji	1,300	234,000
Fakulteti Histori-Filologji			
4	Histori	1,500	270,000
5	Gjeografi	1,500	270,000
6	Gjuhë-letërsi	1,500	270,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	1,500	270,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8	Psikologji	1,500	270,000
9	Punë sociale	1,500	270,000
Universiteti Politeknik			
1	Inxhinieri.mekanike. (Edukum nëdistancë)	2,000	360,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	1,100	198,000
2	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
3	Kontabilitet-financë	1,100	198,000
4	Administrim publik	1,100	198,000
5	Turizëm	1,100	198,000
6	Histori-gjeografi	1,100	198,000
7	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8	Bio-kimi	1,100	198,000
9	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			

1	Financë	1,100	198,000
2	Menaxhim	1,100	198,000
3	Marketing	1,100	198,000
4	Turizëm	1,100	198,000
5	Turizëm/Pogradec	1,100	198,000
Fakulteti i Mësuesisë			
6	Cikli i ulët	1,100	198,000
7	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
8	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i Bujqësisë			
9	Agrobiznes	1,100	198,000
10	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
11	Punonjës social	1,100	198,000
12	Filozofi-sociologji	1,100	198,000
13	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
14	Histori-gjeografi	1,100	198,000
15	Edukatë qytetare	1,100	198,000
16	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
17	Administrim-biznes	1,100	198,000
18	Cikli i ulët	1,100	198,000
19	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
20	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
21	Biologji-kimi	1,100	198,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	1,100	198,000
2	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
3	Turizëm	1,100	198,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4	Drejtësi	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave të Edukimit			
5	Cikli i ulët	1,100	198,000
6	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
7	Matematikë	1,100	198,000
8	Fizikë	1,100	198,000
9	Biologji-kimi	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
11	Histori	1,100	198,000
12	Gjeografi	1,100	198,000

VENDIM

Nr.827, datë 6.10.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.488, DATË 23.4.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË PRONËS SË PALUAJTSHME, NR.663, TRUALL, ISH-REPARTI
USHTARAK I ARTILERISË, NR.6650 NË PARANGUA, BERAT, SI DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.488, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, fjalët "... nr.663, truall, ish – reparti ushtarak i artilerisë, nr.6550 në Prangua..." zëvendësohen me "...nr.1025 "Objekte të repartit ushtarak nr.5013", me vendndodhje në Dushnik...".

2. Në pikën 1, fjalët "...nr.663, truall, zona kadastrale 8505 k-34-112-(223-b), ish-reparti ushtarak i artilerisë, nr.6550, në Prangua, Berat, zëvendësohen me "...nr.1025 "Objekte të repartit ushtarak nr.5013, me vendndodhje në Dushnik, Berat, e cila ndodhet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes...".

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.828, datë 13.10.2010

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1282, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA,
NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2009-2010"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 35 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.1. Kuota për transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme, për kandidatët nga brenda dhe jashtë vendit, është 5.

2.2. Modalitetet e transferimit të studimeve realizohen nga institucioni i arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e tij."

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.829, datë 28.7.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE
MINISTERIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, TË
PRONËS “QENDËR REKRUTIM- MOBILIZIMI”, NË ELBASAN, DHE KALIMIN NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT, TE MINISTERIA E MBROJTJES, TË PRONËS
“LABORATOR USHQIMI”, NË ELBASAN, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes dhe Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të pronës nr.285 “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në Elbasan.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, te Ministria e Mbrojtjes, të pronës “Laborator ushqimi”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr.8525 në Elbasan, me sipërfaqe 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m².

3. Prona nr.285 me emërtesë “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në Elbasan, me sipërfaqe 710 (shtatëqind e dhjetë) m², të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, dhe të marrë emërtimin “Laborator ushqimi”. Prona të jetë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në inventarin me nr.17 të kësaj ministrie.

4. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Prona me emërtesë “Laborator ushqimi”, në zonën kadastrale nr.8525 me sipërfaqe 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m², në Elbasan, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe të marrë numërtimin prona nr.285, me emërtimin “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Ministrisë së Mbrojtjes i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

7. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.830, datë 13.10.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.903, DATË 26.8.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE
INOACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas nënndarjes “vi” të shkronjës “a” të pikës 4 të vendimit nr.903, datë 26.8.2009 të Këshillit të Ministrave, të shtohet nënndarja “vii”, me këtë përmbajtje:

“vii) Fondi për bashkëpunimin shkencor e teknologjik dypalësh me vendet e tjera.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.831, datë 20.10.2010

PËR NGRITJEN E KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCËS CIVILE, PËR
PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR, SI PASOJË E KUSHTEVE ATMOSFERIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencës Civile, për përballimin e situatës së krijuar, si pasojë e kushteve atmosferike, dhe për parandalimin e situatave të tjera, në të ardhmen.

2. Ky komitet të kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Komiteti Ndërmintor i Emergjencës Civile për hartimin e menjëhershëm të një plani masash për përballimin e situatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.835, datë 21.10.2010

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Shpenzime operative”, të shtohet fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

b) Në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, për AKBN-në, në projektin “Dixhitalizimi i industrisë minerare”, të ngurtësohet fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, në dispozicion për fond rezervë të buxhetit.

2. Fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, i përmendur në shkronjen “a” të pikës 1, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.837, datë 21.10.2010

PËR SHKARKIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT VLORË

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zoti Hasan Halili shkarkohet nga detyra e prefektit të qarkut Vlorë.

2. Zoti Eduart Veçani emërohet prefekt i qarkut Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.864, datë 23.7.2010

PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE JURIDIKË, PUBLIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 10, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësve të administratës publike, bazuar në funksionet që kryejnë, u ofrohet shërbimi i telefonisë celulare sipas specifikimeve të këtij vendimi. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, përjashtuar shpenzimet për shërbimin sipas pikave 2, 3 e 10 të këtij vendimi, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.

2. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare dhe pa asnjë kufizim në mbulimin e shpenzimeve nga buxheti i institucionit, funksionarëve, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 63 000 (gjashtë e tre mijë) lekë në muaj, funksionarëve, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj funksionarëve, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, funksionarëve, sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo me shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, funksionarëve, sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj, për funksionin “zëvendësministër”.

8. Ky shërbim mund t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, funksionarëve, sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Ky shërbim mund t’u ofrohet, dhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 4 000 (katër mijë) lekë në muaj, për funksionin “drejtor drejtorie në ministri” (niveli II-b), si dhe çdo funksionari të barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfshihen edhe funksionet “këshilltar” apo “zëdhënës shtypi” që kanë pagë të këtij niveli.

10. Shërbimi i telefonisë “Roaming” ofrohet pa pagesë për të gjitha telefonatat zyrtare të kryera nga jashtë vendit, për funksionin: “zëdhënës shtypi/këshilltar për median” i Presidentit, i Kryetarit të Kuvendit, i Këshillit të Ministrave dhe i Kryeministrit.

11. Drejtuesit e organeve të pushtetit vendor kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.

12. Drejtuesit e njërive të fondeve speciale kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë, në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative (pa koston e personelit), të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.

13. Drejtuesit e ndërmarrjes/shoqërisë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionojnë sipas ligjeve specifike përkatëse, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative, të miratuara në planin financiar përkatës.

14. Njësitë e qeverisjes qendrore, vendore apo fondeve speciale, lidhin kontratat për këtë shërbim me cilindo prej operatorëve telefonikë që veprojnë në vend, të cilët kanë epërsi në përmbushjen e këtyre kushteve:

- ofrojnë çmimin më të ulët;
- ofrojnë cilësinë më të mirë;
- ofrojnë shtrirjen më të gjerë të mbulimit me sinjal.

15. Në çdo rast, shërbimi i ofruar nga institucioni paguhet sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar. Çdo tejkalim i limitit mujor, të përcaktuar sipas pikave 3-9 të këtij vendimi, nuk kompensohet me limitin e muajit pasardhës dhe përballohet nga vetë personi zyrtar.

16. Vendimi nr.343, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 nëntor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

1. Presidenti i Republikës
2. Kryetari i Kuvendit
3. Kryeministri
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
5. Prokurori i Përgjithshëm

Lidhja nr.2

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë

Lidhja nr.3

1. Zëvendëskryetari i Kuvendit
2. Zëvendëskryeministri

Lidhja nr.4

1. Avokati i Popullit
2. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
3. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit
4. Ministri
5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit

Lidhja nr.5

1. Sekretari i Përgjithshëm në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave
2. Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, i Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit, si dhe çdo funksionar i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse për funksion më të madh se ky funksion.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
5. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve

Lidhja nr.6

1. Sekretari i Përgjithshëm në ministri
2. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe çdo funksionar i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse për funksion më të madh se ky funksion.

UDHËZIM
Nr.37, datë 5.11.2010

**PËR FUNKSIONET, PËRGJEGJËSITË DHE PROCEDURAT QË DO TË ZBATOHEN NGA
AVOKATI I TATIMPAGUESVE DHE PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN NGA
TATIMPAGUESIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim, që në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rregullojë organizimin, funksionimin, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve.

Rregullimet e përshkruara në këtë udhëzim për Avokatin e Tatimpaguesit, synojnë të japin, në mënyrë të qartë e të detajuar, rolin, përgjegjësitë dhe kompetencat, si edhe procedurat administrative për t’u ndjekur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

1. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit

1.1. Avokati i Tatimpaguesve (AT) ka si mision mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit, nëpërmjet shqyrtimit të çdo ankese e kërkesë të kualifikuar që bëhet nga tatimpaguesit apo përfaqësues të tatimpaguesve. Ky mision realizohet kryesisht nëpërmjet kompetencës së tij për urdhërimin e kryerjes së verifikimeve apo hetimeve nga drejtoritë rajonale tatimore dhe/ose nga drejtoritë funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe nëpërmjet kompetencave këshillimore tek autoritetet kompetente për zgjidhjen e problemeve të tatimpaguesve. Çdo vendim për të implementuar masa korigjuese merret nga vetë drejtoritë rajonale e funksionale, dhe jo nga AT-ja. Në qoftë se AT dhe drejtoria funksionale ose rajonale nuk bien dakord mbi ndonjë çështje, atëherë AT gëzon autoritetin për ta ngritur verifikimin dhe investigimin në fjalë në nivelin e duhur, që është ai i zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, dhe në fund, nëse e gjykon të nevojshme, edhe në nivelin e Drejtorit të Përgjithshëm.

1.2. Avokati i Tatimpaguesve, në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tij është i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit dhe e ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesve.

1.3. Avokati i Tatimpaguesve promovon të drejtat e tatimpaguesve. Ai ka një rol të rëndësishëm në grumbullimin dhe në përhapjen e informacionit, lidhur me të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

1.4. Avokati i Tatimpaguesve siguron një informacion nga rastet e trajtuara, bën analiza përgjithësuese dhe ua prezanton ato hallkave administrative përkatëse, duke propozuar dhe rrugët për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e procedurave.

2. Organizimi i Avokatit të Tatimpaguesit

2.1. Avokati i Tatimpaguesve është i organizuar në nivel drejtorie brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2.2. Avokati i Tatimpaguesve emërohet nga Ministri i Financave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Ai i raporton drejtpërsëdrejti Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe funksionon në cilësinë e përfaqësuesit të tij direkt, brenda agjencisë dhe me publikun. Ashtu si Drejtori i Përgjithshëm, ai gëzon autoritetin unik për t’u marrë drejtpërdrejt me drejtuesit dhe punonjësit në të gjitha funksionet e të gjitha niveleve të organizatës, kur një gjë e tillë është e përshtatshme. Për të nxitur përgjegjshmërinë, është më mirë që shumica e veprimeve të fillojnë nga drejtuesit, edhe pse në të mirë të shpejtësisë, një gjë e tillë nuk do të jetë gjithmonë e përshtatshme.

2.3. Stafi i Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit merret në punë nga drejtoria e personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me rregullat e shërbimit civil.

2.4. Avokati i Tatimpaguesve mund të jetë çdo person që plotëson këto kushte:

- a) të ketë njohuri të mjaftueshme për sistemin tatimor në Shqipëri;
- b) të ketë eksperiencë pune në administratën tatimore;
- c) të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;
- d) të ketë aftësi të forta ndërpersonale komunikimi.

3. Autoriteti, detyrat dhe funksionet kryesore të Avokatit të Tatimpaguesit

3.1. Krijimi i Avokatit të Tatimpaguesit është një garanci shtesë për mbrojtjen e sigurimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të tatimpaguesve nga ana e administratës tatimore.

3.2. Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat administrative në veprimtarinë tatimore dhe heton pretendimet për veprime të papërshtatshme ose mungesën e veprimeve nga autoritetet tatimore, në bazë të ankesave të paraqitura ose me iniciativën e tij.

3.3. Avokati i Tatimpaguesve kryen detyra që lidhen me mbrojtjen e tatimpaguesve nga veprime të papërshtatshme të autoriteteve tatimore ose mosveprimi i atyre, si rezultat i të cilave preken e cenohen të drejtat dhe interesat e ligjshme të tatimpaguesve.

3.4. Avokati i Tatimpaguesve ndjek me përgjegjësi e përkushtim çdo rast të mbërritur në adresë të tij dhe synon marrëveshje me drejtoritë rajonale ose drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, masat që duhen marrë dhe procedurat që duhet të ndiqen për zgjidhjen e rasteve konkrete.

3.5. Avokati i Tatimpaguesve monitoron dhe heton vetëm procedurën e përcaktuar në ligj apo akte nënligjore dhe nuk ka kompetencë të shqyrtojë raste që kanë të bëjnë me përcaktimin e detyrimit tatimor apo raste që janë në proces apelimi.

3.6 Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të shqyrtojë çështje që janë subjekt i juridiksionit të drejtorive të investigimit të brendshëm dhe të hetimit tatimor.

3.7. Avokati i Tatimpaguesve nuk është hallkë e rishikimit administrativ tatimor dhe as nuk e zëvendëson atë. Të kontaktosh Avokatin e Tatimpaguesit për asistencë nuk e pezullon afatin kohor, brenda të cilit mund të paraqitet një apelim.

3.8. Avokati i Tatimpaguesve nuk ka të drejtë të shprehet në lidhje me themelin e një çështjeje administrative tatimore, e cila është në proces hetimi apo apelimi e për rrjedhojë do të përfundojë me një vlerësim tatimor apo vendim nga Drejtoria e Apelit Tatimor.

3.9. Në zbatim të legjislacionit tatimor dhe për më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri nga ana e organit tatimor, Avokati i Tatimpaguesve monitoron procedurat e ndjekura nga administrata tatimore në procesin e administrimit të tatimeve.

3.10. Avokati i Tatimpaguesve merr pjesë, është i ftuar dhe është aktiv në të gjitha diskutimet për ndryshimet në proceset e punës dhe procedurat e deklaramit, vlerësimit, mbledhjes, kontrollit dhe investigimit tatimor dhe përfaqëson në këto takime interesat e tatimpaguesve. Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm të territorit dhe departamentit duhet ta përfshijnë atë si pjesëmarrës në diskutimet/takimet që kanë të bëjnë me politikën, nismat e reja dhe prioritetet e programit.

3.11. Avokati i Tatimpaguesve do të marrë pjesë edhe në forumet dhe organizimet e biznesit për çështje që lidhen me aspektet e administrimit tatimor, madje edhe duhet të iniciojë takime me bizneset për diskutimin e situatave që kanë të bëjnë me probleme të procedurave të administrimit të tatimeve.

3.12. Avokati i Tatimpaguesve duhet të gëzojë akses të plotë e të menjëhershëm tek informacioni dhe dokumentacioni i disponuar dhe administruar nga administrata tatimore në të gjitha nivelet.

3.13. Avokati i Tatimpaguesve ka autoritet të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore.

3.14. Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin të urdhërojë:

a) Urdhri i çështjes: drejtoritë rajonale tatimore për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve, lidhur me ankesa të veçanta që i paraqiten Avokatit të Tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtori

rajonale duhet të informojë Avokatin e Tatimpaguesve se ai e ka zgjidhur problemin ose t'i kërkojë Avokatit që të bjerë dakord se provat e disponueshme tregojnë se kërkesa e tatimpaguesit për t'u çliruar nga hetimi, është pa vend.

b) Urdhri i procedurës: drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet të shqyrtojë procedurat ekzistuese, të cilat mund të jenë duke shkaktuar probleme të pajustificueshme për tatimpaguesit. Brenda 30 ditëve, drejtorët funksionalë duhet të informojnë Avokatin, nëse ata e kanë ndryshuar procedurën ose t'i kërkojnë atij të bjerë dakord se ndryshimi nuk është i nevojshëm.

c) Në të dyja rastet këto urdhra nuk pezullojnë procedurat e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

3.15. Shkresat (urdhurat), opinionet dhe rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Tatimpaguesve, duhet të trajtohen me përgjegjësi nga hallkat përkatëse të administratës tatimore dhe të gjejnë përgjigje.

3.16. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal ose funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e një problemi ose për ndryshimin e një procedure, atëherë Avokati, si përfaqësues i Drejtorit të Përgjithshëm, duhet ta udhëzojë drejtorin që t'ia referojë çështjen zëvendës drejtorit të përgjithshëm për shqyrtim dhe rishikim. Zëvendës drejtori i përgjithshëm duhet të konsultohet fillimisht me Avokatin dhe më pas duhet t'i përgjigjet atij brenda shtatë ditëve pune, lidhur me vendimin e tij.

3.17. Nëse zëvendës drejtori i përgjithshëm dhe Avokati i Tatimpaguesve nuk bien dakord për sa i përket një ankese për një çështje tatimore apo procedurale, Avokati do të jetë përgjegjës që të planifikojë një takim për diskutimin dhe shqyrtimin e çështjes me Drejtorin e Përgjithshëm, i cili merr vendimin përfundimtar. Asnjë nga palët nuk duhet të takohet me Drejtorin e Përgjithshëm në veçanti për të diskutuar pozicionin e tyre, kur pala tjetër mungon.

3.18. Avokati i Tatimpaguesve bën analizimin e rasteve dhe rekomandon aplikimin e procedurave të unifikuara për aspekte të caktuara të administrimit tatimor me qëllim parandalimin e praktikave të kundërshtuara nga tatimpaguesit.

3.19. Sipas ligjit, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të propozojë masa disiplinore për punonjësit e administratës tatimore që, nga analizimi i rasteve të procesuara prej tij, rezultojnë se kanë kryer veprime me dashje për të dëmtuar një tatimpagues apo të shkelin ligjin ose procedurat. Por, para se ta kryejë këtë gjë, Avokati i Tatimpaguesve duhet t'i paraqesë provat e tij te punonjësi drejtues i duhur dhe ta inkurajojë këtë person që të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

3.20. Avokati i Tatimpaguesve ka kompetencë të rekomandojë masa korrigjuese dhe po të jetë rasti, edhe ndryshime në legjisllacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore.

4. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të çështjeve

4.1. Çdo tatimpagues apo grup tatimpaguesish, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshëm, qofshin këto individuale apo të përbashkëta, nga veprimet e paligjshme apo të parregullta të administratës tatimore qendrore ose mosveprimet e saj, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Tatimpaguesit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për rregullimin e situatës, në lidhje me një të drejtë të shkelur apo të mohuar.

4.2. Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës.

4.3. E drejta për t'u ankuar te Avokati i Tatimpaguesve lind vetëm pasi të jetë konsumuar një herë me shkrim e drejta për t'u ankuar te drejtoria rajonale përkatëse apo drejtoritë funksionale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që kanë nën juridiksion shqyrtimin/administrimin e procedurës së kontestuar nga tatimpaguesi apo grupi i tatimpaguesve ankues.

4.4. Nëse tatimpaguesi ankues/kërkues nuk ka marrë përgjigje apo zgjidhje nga hallka e parë brenda 30 ditëve nga dita e depozitimit të shkresës kërkuese, mund t'i kërkojë apo të njoftojë me shkrim Avokatin e Tatimpaguesit, në lidhje me procedurën të cilën konteston dhe pretendon që shkel të drejtat apo interesat e tij.

4.5. Avokati i Tatimpaguesve, pasi i mbërrin ankesa, kërkesa apo njoftimi për një shkelje apo procedurë të kontestuar, e protokollon atë në një regjistër të veçantë të administruar nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

4.6. Regjistrimi i veçantë i shkresave të mbërritura në adresë të Avokatit të Tatimpaguesit bëhet me qëllim të lehtësimit të procedurave të mbërritjes së ankesave/njoftimeve, si edhe me qëllim analizimin e rasteve të njoftuara në atë drejtori.

4.7. Shkresat e procesuara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit firmosen nga Avokati i Tatimpaguesve dhe mbajnë vulën e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit me shënimin “Avokati i Tatimpaguesve”.

4.8. Pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, Avokati i Tatimpaguesve vendos:

- a) të pranojë çështjen për shqyrtim;
- b) të mos pranojë çështjen për shqyrtim.

4.9. Në rast të mosfillimit të shqyrtimit të një çështjeje nga ana e Avokatit të Tatimpaguesit për një nga arsyet që e përligjin mosfillimin, ky vendim duhet t'i njoftohet kërkuarit së bashku me arsyen. Vendimi i Avokatit për këtë çështje mund të mos apelohej apo t'i referohet një drejtuesi më të lartë për t'u rishikuar.

4.10. Avokati i Tatimpaguesve fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike.

4.11. Në rast të plotësimit të kushteve për pranimin e ankesës apo kërkesës, Avokati i Tatimpaguesve njofton të interesuarit, duke u kthyer përgjigje me shkrim, me e-mail apo telefon, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankesës, kërkesës ose njoftimit dhe, sipas rastit, e njofton tatimpaguesin se ka nisur një procedurë hetimore që mund të zgjasë më shumë.

4.12. Në rastet kur ankesa apo kërkesa kërkon zhvillimin e një verifikimi apo hetimi nga një drejtori tatimore rajonale, Avokati i Tatimpaguesve, jo më vonë se 15 ditë nga data e pranimit të ankesës, i dërgon drejtorisë përkatëse rajonale tatimore një shkresë (urdhër për rishikim praktike), në të cilën jepen të dhëna të sakta identifikuese të ankimuesit, përfshirë problemet që duhet të verifikohen apo zgjidhen, duke vënë dhe afate konkrete për kryerjen e verifikimeve apo zgjidhjen e problemeve. “Urdhri për rishikimin e një praktike”, i lëshuar nga Avokati i Tatimpaguesve për drejtorinë rajonale tatimore përkatëse, do të ketë formën sipas modelit nr.1, bashkëngjitur. Avokati i Tatimpaguesve vendos nëse duhet t'i bashkëngjisë ose jo “Urdhrit për rishikimin e një praktike”, kopje të ankesës apo dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ankimuesi.

4.13. Drejtoria rajonale tatimore duhet të kryejë hetimet e nevojshme dhe të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Avokatit të Tatimpaguesit, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së shkresës (urdhrit) nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

4.14. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor rajonal nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori rajonal do t'ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të përgjithshëm territorial që mbulon drejtorinë rajonale në fjalë.

4.15. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm territorial përkatës nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri rishikimi praktike”, rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

4.16. Në rastet kur një ankesë lidhet me një procedurë tatimore që duhet të trajtohet nga një drejtori funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Avokati i Tatimpaguesve përgatit një shkresë (urdhër rishikimi procedural) që i drejtohet drejtorisë përkatëse funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Urdhri i rishikimit procedural do të hartohet sipas modelit nr.2 bashkëngjitur.

4.17. Drejtoria funksionale përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duhet t'i përgjigjet Avokatit të Tatimpaguesit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së urdhrit për rishikim procedural.

4.18. Nëse Avokati i Tatimpaguesve dhe një drejtor funksional në DPT nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri për rishikim të një procedure”, Avokati i Tatimpaguesve dhe drejtori funksional do t’ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të përgjithshëm që mbulon drejtorinë funksionale përkatëse.

4.19. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm funksional nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një “Urdhri për rishikim procedure”, rasti i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

4.20. Avokati i Tatimpaguesve duhet të ruajë konfidencialitetin për informacionin e dhënë nga ankimuesi, duke mos e paraqitur atë të plotë të drejtoria rajonale me të cilën lidhet ankimi, për sa e gjykon të arsyeshme, si dhe nëse kjo kërkohet nga personi që bën ankesën, kërkesën apo njoftimin.

4.21. Me përfundimin e procedurës së rishqyrtimit, jo më vonë se 10 ditë nga data e përfundimit të rishqyrtimit, Avokati i Tatimpaguesve bën njoftimin e ankimuesit nëpërmjet një opinionimi përmbledhës me rezultatet e rishqyrtimit dhe mbyll praktikën duke bërë edhe arkivimin e saj. Nëse tatimpaguesi është i kënaqur nga zgjidhja e çështjes, ky njoftim mbylljeje mund të bëhet dhe me gojë. Data dhe ora e njoftimit me gojë duhet të regjistrohet në kopjen e urdhrin të mbylljes që ndodhet në zyrën e Avokatit.

4.22. Administrimi i kërkesave, njoftimeve apo ankesave të mbërritura tek Avokati i Tatimpaguesve do të bëhet nëpërmjet një programi kompjuterik, i cili në çdo kohë mund të japë informacion në lidhje me ankuesin, objektin e ankimit, ecurinë e trajtimit nga Avokati i Tatimpaguesve, që nga marrja në shqyrtim e deri te mbyllja e çështjes me shënimet përkatëse të arsyeve dhe rezultateve të mbylljes.

4.23. Në asnjë rast ankimi, kërkesa apo njoftimi i depozituar pranë Avokatit të Tatimpaguesit nuk e pezullon procedurën e shqyrtimit nga ana e drejtorive rajonale apo drejtorive funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për çështjet që janë objekt i ankimit, kërkesës apo njoftimit dhe as procedurën e ekzekutimit të akteve që kanë dalë nga administrata tatimore për ato çështje.

4.24. Çdo shërbim që ofrohet nga Avokati i Tatimpaguesve është pa pagesë.

5. Raportimi

5.1. Avokati i Tatimpaguesve raporton me shkrim periodikisht një herë në muaj te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe një herë në tre muaj te Ministri i Financave.

5.2. Përveç raportimit të zakonshëm periodik, ai i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Ministrin të Financave, sa herë që i kërkohet prej tyre.

5.3. Në rastet që e gjykon të arsyeshme, Avokati i Tatimpaguesve ka të drejtë të kërkojë të raportojë te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për situata apo çështje të veçanta, përveç raportimit periodik.

5.4. Raportimi mujor duhet të përfshijë: një raport mujor drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe një raport tremujor drejtuar Ministrin të Financave. Këto raporte do të përfshijnë:

5.5. Të dhëna cilësore lidhur me:

i) Numrin e ankesave të marra, të pranuar për investigim që lidhen me çështjet dhe numrin e atyre të refuzuara. Numrin e çështjeve të mbyllura. Numrin e çështjeve që mbeten të hapura dhe përqindjen e atyre që janë të vjetra. Numrin e çështjeve për të cilin ankesa e tatimpaguesit është përcaktuar e pavlefshme. Numri i çështjeve të mbyllura, ku vendimi ka qenë në favor të tatimpaguesit dhe volumi i çështjeve sipas funksionit, do të raportohen gjithashtu.

ii) Numri i urdhrave proceduralë për shqyrtim që janë lëshuar, mbyllur, mbeten të hapur, si dhe përqindja e urdhrave të vjetër. Numri i urdhrave të mbyllur proceduralë për shqyrtim, ku vendimi përfundimtar është mbështetur nga rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit.

iii) Numri i herëve që Avokati i Tatimpaguesve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm kanë rishikuar një rast të shqyrtuar apo një urdhrë të ndryshuar dhe kanë arritur apo jo në një marrëveshjeje.

iv) Për raportin tremujor që i drejtohet Ministrisë së Financave, raporti duhet të përcaktojë numrin e herëve që Drejtorit të Përgjithshëm i është kërkuar të japë një vendim përfundimtar deri në

atë masë sa rezultati është mbështetur nga pozicioni i zëvendës drejtorit të përgjithshëm apo ai i Avokatit.

5.6. Problematika dhe çështje që lidhen me politikat e administrimit:

i) Përshkrim të problemeve që hasen më shpesh, shkaqet e tyre dhe veprimet e nevojshme për të pakësuar problem të ngjashme në të ardhmen.

ii) Raporti do të identifikojë gjithashtu çështje të ligjit dhe politikës që rritin përgjegjësinë ndaj tatimpaguesve, të cilët tentojnë të përmbushin vullnetarisht detyrimet tatimore.

5.7. Raportet mujore dhe tremujore do të përshkruajnë takime dhe forume në sektorin privat, ku Avokati i Tatimpaguesve apo personeli i tij kanë bërë prezantime dhe kanë kërkuar opinionin e tatimpaguesve.

5.8. Raporti mujor do t'i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve brenda datës 10 të muajit të ardhshëm. Raporti tremujor do t'i paraqitet Ministrit të Financave brenda datës 20 të muajit të ardhshëm (muaji që pason çdo tremujor në kalendar).

6. Hyrja në fuqi

6.1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Model nr. 1: “Urdhër për rishikim praktike”



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Avokati i Tatimpaguesve

Nr. Prot.

Tiranë, më

L ë n d a : Urdhër për rishikim praktike.

Drejtuar: Drejtorisë rajonale tatimore _____

I nderuar z. _____ ,

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit (personit) _____ , me NIPT _____ lidhur me problemin _____.

Bazuar në dispozitat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr.____, datë _____, urdhëroj kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe shqyrtimit të problemit që vijon:

Përshkrim i ankesës: _____

_____

Bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi të na dërgoni rezultatet e shqyrtimit të praktikës brenda 30 ditëve nga marrja e këtij urdhri.

Avokati i Tatimpaguesve

Model nr. 2: “Urdhër rishikimi procedural ”



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Avokati i Tatimpaguesve

Nr. Prot.

Tiranë, më

L ë n d a : Urdhër për rishikim procedure.

Drejtuar: Drejtorisë së _____ në DPT

I/e nderuar z. _____ ,

Avokati i Tatimpaguesve po shqyrton ankesën e tatimpaguesit (personit) _____ , me NIPT _____ ose ankesën e institutit/shoqatës/përfaqsisë së tatimpaguesve etj.....lidhur me problemin _____.

Bazuar në dispozitat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr. ____, datë _____, urdhëroj rishikimin e procedurës: _____

_____

Bashkëngjitur janë fakte dhe argumente lidhur me këtë ndryshim.

Bazuar në dispozitat e udhëzimit të sipërpërmendur, lutemi të na dërgoni rezultatet e shqyrtimit të praktikës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij urdhri.

Avokati i Tatimpaguesve

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 16.11.2010

Doli nga shtypi më 18.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë